



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:007168  
Datë: 16.04.2024  
Numri i dokumentit: 05579760

C.nr.1683/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit Q.Z, nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, kundër të paditurës N.Z nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, për kompensimin e dëmit për shkak të shpifjes dhe fyerjes, në vlerë prej 900.00, euro, më datën 16.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hedhet poshtë si e pasafatshme - padia e paditësit Q.Z, nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, kundër të paditurës N.Z nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, për kompensimin e dëmit për shkak të shpifjes dhe fyerjes, në vlerë prej 900.00, euro.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi Q.Z, nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, pranë kësaj gjykate me datë 29.12.2023, ka paraqitur padi kundër të paditurës N.Z nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, për kompensimin e dëmit për shkak të shpifjes dhe fyerjes, në vlerë prej 900.00, euro.

Paditësi ndër të tjera ka theksuar se paditësja sa ishte duke u mbajtur përvjetori i masakrës së Krushë e Madhe me datë 26.03.2023, ka shpifur, kinse paditësi i ka hyrë në shtëpinë e saj dhe i ka vjedhur orën e djalit të saj, këto fjalë-shpifje e paditura ia ka thënë tezës së tij, e cila është e martuar për xhaxhain e tij i cili jeton në Zvicër.

Po ashtu paditësi në padi ka deklaruar se për këtë shpifje ka kuptuar në fund të muajit korrik, ku kushëriri i tij, H.Z ka treguar se e paditura iu ka thënë të afërmve të paditësit se ai ia ka thyer shtëpinë dhe ia ka vjedhur orën e djalit.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për rregullsinë e padisë deri te ky konstatim erdhi duke u bazuar në shkresat e lëndës, sipas të cilave rezulton se paditësi ka kuptuar për shpifjen në fund të muajit korrik 2023, dhe është dashur që t'i drejtohet me padi gjykatës brenda afatit prej 3 muajve, por që padinë në gjykatë e ka paraqitur më datë 29.12.2023, pas rreth pesë (5) muajve, që do të thotë se të njëjtën e ka ushtruar jashtë afatit të paraparë ligjor.

Me dispozitat e Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, nr. 02/L-65, përkatësisht me dispozitën e nenit 17.1 të këtij ligji parashihet: *“Afati për paraqitjen e një kërkesë për kompensim në bazë të këtij Ligji është tre (3) muaj, nga dita kur personi që pretendohet të jetë i dëmtuar është vënë në dijeni ose duhet të jetë vënë në dijeni për shprehjen e faktit të pavërtetë dhe identitetin e autorit, dhe në asnjë rast nuk duhet të kalojë një (1) vit, nga dita kur shprehja është bërë publike”*.

Ndërsa me dispozitën e nenit 391 pika (f) e LPK-së parashihet se: *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se:.... (pika f) padia është paraqitur pas skadimit të afatit po që se me dispozitat e posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj”*, në rastin konkret afati për paraqitjen e padisë ka qenë i përcaktuar me dispozita materiale, konkretisht me nenin 17 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes.

Gjykata vlerëson se paditësi ka pasur të drejtë ligjore që në mënyrë të lirshme të ushtrojë mjete juridik në rrugë gjyqësore, mirëpo përdorimi i këtyre mjeteve juridike është dashur të bëhet brenda afateve ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 17 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes.

Andaj, mos shfrytëzimi i këtyre mjeteve juridike brenda afateve të caktuara (afate prekluzive), ka si pasojë edhe humbjen e të drejtës për mbrojtje gjyqësore dhe jo për shkak se kjo e drejtë i është mohuar paditësit, por për shkak se ky i fundit ka dështuar që me kohë t'i shfrytëzojë këto mjete juridike të cilat i ka pasur në dispozicion. Paditësi në rastin konkret ka humbur të drejtën në mbrojtje gjyqësore pasi që padinë e ka parashtruar jashtë afatit ligjor nga shkaqet e lartcekura, andaj gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata sa i përket vendimit për shpenzimet procedurale vendosi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta në bazë të dispozitës së nenit 450 dhe 463.1 të LPK-së

Andaj, në bazë të gjendjes faktike dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 391 al. 1 pika f, të LPK-së, është vendosur sikur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil

C.nr.1683/2023, më datën 16.04.2024

Gjyqtari  
Avni Berisha

**KESHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.